



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 19, datë 20.01.2021

MBI

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË FILLUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 225, DATË 15.12.2020 “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 202, SERIA PV13K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “HEC TRESKA” SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 80, DATË 27.04.2013

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 95, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 20.01.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 9/4 prot, datë 15.01.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës, «Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 225, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hec Treska” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 80, datë 27.04.2013”»,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE, me vendimin nr. 225, datë 15.12.2020, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC TRESKA” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE nr. 80, datë 27.04.2013.
- Vendimi i Bordit të ERE nr. 225, datë 15.12.2020, i është dërguar për dijeni shoqërisë “Hec Treska” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së ERE nr. 1172/1-3 Prot., datë 23.12.2020.
- Në vijim të këtij njoftimi, në datë 13.01.2021, nga verifikimet e Drejtorisë së Financës në ERE rezultoi dhe u bë me dije se janë shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit për të cilat rezulton debitore shoqëria.
- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni subjektit, rezultoi se subjekti ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit të përcaktuar në këtë njoftim e të sanksionuar në vendimin e Bordit të ERE nr. 225/2020.

- Për sa më sipër, rezulton se shoqëria “HEC TRESKA” sh.p.k. nuk është debitore ndaj ERE për pagesat e prapambetura të Rregullimit.
- Në nenin 8 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se: Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentat e paraqitur dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t’i propozojnë Bordit a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d" të nenit 5 të kësaj rregulloreje.
- Në nenin 95 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, **kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur**”.
- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast "qëllimi" i procedurës, lidhet ngushtësisht me marrjen e masave ligjore kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimmarrjen.
- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura, faktin ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundërdrejtohet masa administrative duke rezultuar në rënien e shkakut që imponoi marrjen e masës ligjore.
- Në nenin 9, gërma “a” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE nr. 225, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC TRESKA” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE nr. 80, datë 27.04.2013.
2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 225, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC TRESKA” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE nr. 80, datë 27.04.2013.
3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.